Albanska/Shqip

# Mirë se vini në kontrollin tuaj shëndetësor

Me këtë rast ne u ftojmë ju që sapo keni arritur në Suedi të bëni një kontroll shëndetësor. Kontrollin do ta filloni duke takuar një infermiere që do t'u shtrojë pyetje mbi shëndetin tuaj dhe do të marrë prova për t'u vërtetuar nëse vuani nga ndonjë sëmundje infektuese. Me anë të këtij kontrolli shëndetësor ne dëshirojmë të parandalojmë, zbulojmë dhe trajtojmë sëmundje eventuale. Ju mund të vuani nga ndonjë sëmundje infektuese por megjithatë të ndjeheni i/e shëndoshë. Mundësitë për të trajtuar sëmundjet infektuese sot janë të mira.

**Kontrolli shëndetësor për ju do të jetë falas!**

Mos harroni të merrni me vete LMA kartelën!

Mirë se vini në shtëpinë e shëndetit

| |
|---|
| |

Do të takoni infermieren

| |
|---|
| |

| Mirë se vini më | Në ora |
|---|---|
| | |

Nëse nuk keni mundësi të vini në këtë kohë u lutemi të na lajmëroni mbi këtë duke na telefonuar:

| |
|---|
| |

ose ejani te shtëpia e shëndetit me këtë ftesë.

Mirë se vini!